



1-8 MARS

JAVA E MBROJTJES



ERMAL NUFI MERR DETYRËN SI MINISTËR I MBROJTJES

Ermal Nufi ka marrë zyrtarisht detyrën në krye të Ministrisë së Mbrojtjes, në një ceremoni të posaçme të zhvilluar në Garnizonin “Skënderbej”. Detyra iu dorëzua nga ministri në largim, Pirro Vengu, në prani të drejtuesve të Forcave të Armatosura, gjeneralëve dhe partnerëve ndërkombëtarë. Në fjalën e tij të parë, ministri Nufi theksoi përgjegjësinë që mbart ky institucion për sigurinë e vendit dhe për rolin e Shqipërisë në arkitekturën e sigurisë ndërkombëtare.

★★★★★

QPR ÇEL APLIKIMET PËR 200 VENDE NË FA

Qendra e Personel Rekrutimit ka hapur aplikimet për 200 vende në Forcat e Armatosura, për ushtarë, detarë dhe ajrorë aktivë, duke ofruar mundësi për një karrierë profesionale me dinjitet. Stërvitja bazë zhvillohet nga 18 maj deri më 24 korrik 2026, ndërsa afati i aplikimeve është 17 prill 2026; kuotat janë të hapura për Forcat Tokësore, Ajrore, Detare dhe Komandën Mbështetëse.





5 VITE NGA KRIJIMI I ROS

Regjimenti i Operacioneve Speciale shënoi 5-vjetorin e krijimit të tij, duke reflektuar pesë vite profesionalizëm, përgatitje intensive dhe angazhim të pakursyer në shërbim të sigurisë dhe standardeve të NATO-s. Gjatë këtyre viteve, njësia elitare ka dëshmuar se përkushtimi, disiplinë dhe lidershipi janë themeli i çdo misioni të suksesshë





REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E MBROJTJES

Malicious Activity #4

TRAJNIM NË FUSHËN E SIGURISË KIBERNETIKE

Në kuadër të bashkëpunimit me Gardën Kombëtare të New Jersey-t, në ambientet e Qendrës Operacionale Kibernetike u zhvillua trajnimi “Shkëmbim Eksperience në Fushën e Sigurisë dhe Rreziqeve Kibernetike”. Ky trajnim u fokusua në forcimin e kapaciteteve kibernetike dhe aftësimin e personelit në identifikimin, analizimin dhe menaxhimin e kërcënimeve kibernetike, si dhe në testimin e pajisjeve dhe sistemeve të përdorura në operacionet kibernetike.

★★★★★

mod.gov.al

JM



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

PANAIRI WORK & STUDY

Në Panairin “Work & Study” në Krujë, Akademia e Forcave të Armatosura dhe Qendra e Personel Rekrutimit prezantuan programet e studimit dhe mundësitë e punësimit, duke ofruar rrugë për një karrierë me disiplinë dhe zhvillim profesional. Të rinjtë e qytetit shfaqën interes të madh dhe energji pozitive gjatë takimeve.



mod.gov.al

JM



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES



ALBANIA

EKIPI I AFA NË KAMPIONATIN BOTËROR USHTARAK TË VRAPIMIT

Ekipi i Akademisë së Forcave të Armatosura mori pjesë në edicionin e 60-të të Kampionatit Botëror Ushtarak të Vrapimit në Terren, organizuar nga International Military Sports Council, i zhvilluar në Trikala, Greqi. Ky ekip u përfaqësua nga trajnerë, sportistë dhe studentë të Akademisë së Forcave të Armatosura, të cilët garuan në këtë aktivitet prestigjioz ndërkombëtar. Ekipi shqiptar arriti rezultate të vlerësueshme.

★★★★★

mod.gov.al

JM

OPERACION EOD NË SELENICË

Ekipi i specialistëve EOD ka ndërhyrë në bashkinë e Selenicë për vlerësimin dhe largimin e municioneve luftarake të gjetura gjatë punimeve për ndërtimin e urës në lumin Shushica River, në fshatin Kote. Pas ndërhyrjes së ekspertëve, municionet e kalibrave të ndryshëm u larguan dhe kantieri i ndërtimit u rikthye në një zonë të sigurt për vijimin e punimeve.

★★★★★